



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 148, datë 23.11.2011**

**PËR**

**DISA SHTESA NË RREGULLOREN “PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK TË  
DËMEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME MOTORIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren “Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike”, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 30.04.2009, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Elisabeta GJONI**

**Në rregulloren “Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike”, të miratuar me Vendimin nr. 36, datë 30.04.2009, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:**

**1. Në nenin 6, pas pikës 2 shtohet pika 3, si më poshtë vijon:**

“3. I. Në rastet kur një palë e dëmtuar nga një mjet motorik i pasiguruar ose i paidentifikuar (rast që trajtohet nga fondi kompensimit), paraqitet drejtpërdrejt në një shoqëri sigurimi, kjo e fundit pasi hap praktikën e dëmit, të kompletuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ligjor, bën raportimin e kësaj praktike dëmi në regjistrin elektronik online të dëmeve, si për të gjitha rastet e tjera të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke plotësuar të gjitha të dhënat e përcaktuara në aneksin 2 të rregullores.

II. Kur kemi të bëjmë me një mjet të pa siguruar, raste të dëmeve që trajtohen nga fondi i kompensimit, të dhënat për policën e sigurimit të automjetit shkaktar të dëmit, si:

1. Numri serial i policës së sigurimit të shkaktarit.
2. Kodi AMF i policës sigurimit të shkaktarit do jenë të paplotësuara.

III. Kur kemi të bëjmë me një mjet të paidentifikuar, raste të dëmeve që trajtohen nga fondi i kompensimit të dhënat për shkaktarin dhe policën e sigurimit të automjetit shkaktar të dëmit do të jenë të paplotësuara.

Kur praktikat e dëmit objekt i Fondit të Kompensimit, dërgohen për miratim në komisionin e trajtimit të dëmeve pranë BSHS-së, shoqëria bën çregjistrimin e kësaj praktike dëmi duke bërë shënimin “Dërguar Byrosë, Fond Kompensimi”.

Ndërkohë Byroja, këto praktika dëmsh fond kompensimi, të ardhura nga shoqëritë, duhet ti raportojë në regjistrin elektronik online të dëmeve, njësoj si të gjitha praktikat e tjera të dëmeve që hap Byroja në rastet kur pala e dëmtuar paraqitet drejtpërdrejt në Byro për dëmet që mbulohen nga Fondi i kompensimit.”

**2. Në nenin 6, pas pikës 3 shtohet pika 4, si më poshtë vijon:**

“4. I. Praktikrat e dëmeve të kartonit jeshil, do të regjistrohen nga çdo shoqëri në regjistrin elektronik online, brenda 24 orëve nga momenti i hapjes së një dosje të re nga struktura e kartonit jeshil të shoqërisë, pas marrjes së njoftimit të rastit të sigurimit nga korrespondentët apo Byroja e vendit të ndodhjes së aksidentit.

- II. Të dhënat që do të regjistrohen në rastet e praktikave të dëmeve të kartonit jeshil do të jenë të njëjta me ato të dëmeve të TPL, me ndryshimin e vetëm që në vend të numrit të raportit të policisë që kërkohet në rastet e dëmeve TPL, do të vendoset numri i referencës së vendosur nga korrespondenti apo byroja e vendit të ndodhjes së aksidentit dhe në vend të Rajonit të policisë që kërkohet në rastet e dëmeve TPL do të vendoset emri i korrespondentit apo byrosë së vendit nga ka ardhur njoftimi i rastit të sigurimit.
- Statusi i këtyre praktikave do të ndryshohet sipas çdo ndryshimi që do të ndodhë gjatë trajtimit të tyre nga struktura e kartonit jeshil të shoqërisë.”